



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 705/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me apelet e parashtruara nga Elbasan Kaçaniku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara apelet e parashtruara nga Elbasan Kaçaniku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, me shenjë ZL.Anr.705/2017, ZL.Anr.706/2017, ZL.Anr.707/2017, ZL.Anr.708/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, ka pranuar apelet ZL.Anr.705/2017, ZL.Anr.706/2017, ZL.Anr.707/2017, ZL.Anr.708/2017 me datë 09.11.2017, nga parashtruesi i apeleve Elbasan Kaçaniku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, pretendon se në fshatin Krojmir në vendvotimin 1326e, në fshatin Rosinofc në vendvotimin 1324e, në fshatin Gadime në vendvotimin 1307e, në fshatin Topliqan në vendvotimin 1331e, ka pasur keqpërdorime gjatë numërimit të votave, ashtu që nga komisionerët e vendvotimeve iu janë vjedhur votat e tij.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.705/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për katër apelet që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që parashtruesi i ankesës nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apellesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pa argumentuar me fakte dhe si i tillë është i pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.705/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaja



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*